

VENDIM
Nr. 332, datë 18.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR MBIKËQYRJEN DHE
KONTROLLIN E PRODHIMIT, IMPORTIMIT, EKSPORTIMIT, RUAJTJES,
TREGTIMIT DHE PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 17/2020, "Për produktet plehëruese", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama